

# ONLINE MEDIA MONITOR

RAPORTI I MONITORIMIT TË MEDIAVE ONLINE 2018-2019



# **ONLINE MEDIA MONITOR**



**RAPORTI I MONITORIMIT TË MEDIAVE ONLINE 2018-2019**



**Botues:**

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!  
Rruga: UÇK 25-1; Prishtinë, Kosovë  
Tel / +383 (0)38 248 506 [www.cohu.org](http://www.cohu.org)

Ky grant është financuar nga projekti 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

# Përmbajtja

**06** **HYRJE**

**08** **METODOLOGJIA**

**09** **RAPORTI I SHKELJEVE ETIKE**

**10** **SHKELJET E KODIT TË MEDIAVE TË SHKRUARA**

**11** **SHKELJET E EVIDENTUARA GJATË PERIUDHËS NJËVJEÇARE**

**21** **RITJA E NUMRIT TË ANKESAVE DHE NDIKIMI I SHQYRTIMIT TË TYRE**

**22** **PËRFUNDIME**

# Hyrje

Sektori i mediave është njëri prej sektorëve shumë të rëndësishëm të shoqërisë, i cili në njërin anë i informon dhe i 'edukon' qytetarët, derisa në anën tjetër kërkon përgjegjësi dhe llogaridhënie nga institucionet politike dhe publike, duke luajtur kështu rol të zëdhënësit të qytetarëve i cili shpreh brengat dhe nevojat e tyre.

Kosova, si një vend i cili në mileniumin e tretë ka dalë nga lufta dhe ka nisur rimëkëmbjen dhe ndërtimin, është shtet me demokraci mjaft të re. Rrjedhimisht, edhe institucionet e saj të cilat paraqesin shtyllat e një demokracie nuk janë edhe aq të forta dhe ballafaqohen me shumë sfida, e që është pasqyrë e gjendjes së gjithëmbarshme në vend. Sektori i mediave është njëri prej sektorëve shumë të rëndësishëm të shoqërisë, i cili në njërin anë i informon dhe i 'edukon' qytetarët, derisa në anën tjetër kërkon përgjegjësi dhe llogaridhënie nga institucionet politike dhe publike, duke luajtur kështu rol të zëdhënësit të qytetarëve i cili shpreh brengat dhe nevojat e tyre.

Shumë media në Kosovë që nga periudha e pasluftës janë zhvilluar dhe janë ndërtuar me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe rëndom kjo ka pasur efekt pozitiv në aspektin e fuqisë së tyre për t'iu bërë ballë shumë presioneve dhe për ta ruajtur - në atë masë sa kjo është e mundur - pavarësinë e tyre financiare dhe politike.

Në vitin 2004, pesë vjet pas përfundimit të luftës, nis (vetë)rregullimi i mediave. Duke u nisur nga specifikat dhe dallimet ndërmjet mediave audiovizuale dhe atyre të shkruara (kryesisht gazetave atëbotë), u vendos që radiot dhe televizionet të rregulloheshin përmes themelimit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM - <http://www.kpm-ks.org>) derisa pjesa tjetër të vetërregullohej përmes themelimit të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK - <http://presscouncil-ks.org>).

KMShK-ja në atë kohë numëronte 7-8 anëtarë të gazetave ditore nënshkruese të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës (<http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Kodi-i-Mediave-të-Shkruara-të-Kosovës-.pdf>), dhe përbëhej nga një bord redaktorësh të këtyre medimeve të udhëhequr nga një organ i pavarur, nga Kryesia e Bordit. Që nga themelimi i KMShK-së e deri më sot skena e mediave në Kosovë ka pësuar shumë ndryshime. Disa media të shkruara (të përditshmet dhe revistat) u kanë dhënë fund versioneve të tyre të shtypura duke kaluar vetëm në versionet online (Gazeta Express, Kosovo 2.0 etj.), derisa disa të tjera janë shuar përfundimisht (Infopress, Lajmi etj.).

Skena e mediave të shkruara tani është mbushur me media online me qindra mijëra klikime (si matës i ri i cili flet për 'lexueshmërinë', apo vizitat në këto portale), dhe Këshilli i Mediave aktualisht numëron më se 28 anëtarë prej të cilëve vetëm 3 janë të përditshme klasike (Koha Ditore, Zëri dhe Epoka e Re). Ky fakt e bën Këshillin e Mediave më shumë vetërregullues të mediave online sesa të atyre të shtypura dhe ky fakt në vete bart edhe shumë kërkesa dhe nevoja për reformimin e këtij trupi vetërregullues, duke filluar nga amendamenti i Kodit të Mediave të Shkruara, nxjerrja e udhëzuesve të ri për mediat online, specifikat për anëtarësim e kështu me radhë.

Megjithëse në mandatin e KMShK-së ekziston mundësia që vet të inicojë raste kur has në shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara nga një anëtar apo joanëtar, ky trup vetërregullues për arsye të ndryshme nuk e aplikon këtë mundësi (nuk ka informacione nëse një rast i tillë ka ndodhur ndonjëherë në këto 14 vjet funksionimi).

Si pasojë e kësaj, Këshilli pranon ankesa nga 'palët e prekura', gjegjësisht nga institucionet apo individët të cilët pretendojnë se një medium i shkruar ka shkelur Kodin e Mediave të Shkruara me botimin e një lajmi i cili në një anë apo tjetrën implikon palën ankuese.

Duke qenë se as Këshilli (dhe as ndonjë organ tjetër në Kosovë) nuk bën monitorimin e mediave të shkruara (online), siç bën KPM-ja në rastin e mediave audiovizuale, numri i ankesave të pranuar nga Këshilli kurrsesi, në asnjë rrethanë, nuk pasqyron gjendjen e shkeljeve të etikës së gazetarisë në Kosovë.

Këtu edhe vjen në shprehje nevoja dhe mundësia për intervenim. Projekti që ka prodhuar raportin para jush ka për synim ta 'marrë përsipër' kompetencën *ex officio* të Këshillit të Mediave të Shkruara, duke i monitoruar portalet më aktive në Kosovë, duke evidentuar shkeljet e tyre ditore dhe duke dorëzuar ankesa pranë Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës për shkeljet më flagrante të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

# Metodologjia

Metodologjia e punës së këtij projekti është krejtësisht e re. Projekti ka angazhuar 3 studentë të gazetarisë të cilët kanë bërë monitorim ditor të portaleve të përzgjedhura duke evidentuar shkelje të Kodit dhe duke përpiluar ankesa të cilat i dorëzohen Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Studentët janë konsideruar si kategori më të përshtatshme për t'u angazhuar për këtë aktivitet. Ata janë në radhë të parë qytetarë dhe ankesat e tyre kanë qenë ankesa individuale (të qytetarëve) për një shkelje e cila në mënyrë të tërthortë i prek ata. Kësisoj **është synuar** të instalohet edhe fryma e angazhimit qytetar për ta ngritur zërin për shqetësimet e njëri-tjetrit dhe të komunitetit në përgjithësi.

Studentët e gazetarisë **të cilët janë përfshirë në monitorim janë trajnuar** duke marrë informacione të detajuara për:

Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës;  
Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës;  
Shembuj të shkeljeve të rëndomta të Kodit të Mediave;  
Mënyra të përpilimit dhe dorëzimit të ankesave pranë Këshillit të Mediave;

Studentët e përzgjedhur janë njohur me planin e zbatimit, afatet dhe rezultatet e pritura. Metod-

ologjia ka paraparë edhe ndërrimin e mundshëm (rokada) të studentëve të angazhuar në periudha 6-mujore.

Qëllimi kryesor i këtij raporti dhe i këtij angazhimi **është qasja në komunitet dhe përfshirja e komunitetit. Duke qenë se, sipas të dhënave në dispozicion, Këshilli i Mediave gjatë kësaj periudhe** 14-vjeçare të funksionimit kryesisht ka pranuar ankesa qoftë nga institucionet publike (Presidenca, Kryeministri, deputetët, bizneset e kështu me radhë) qoftë nga individët e apostrofuara në lajme, artikuj dhe opinione kundërtënëse, metodologjia jonë ka nxitur qasjen në komunitet dhe përfshirjen e tij.

Rritja e numrit të ankesave të individëve të cilët nuk janë të prekur drejtpërdrejt nga shkeljet potenciale të etikës së gazetarisë u jep shembull qytetarëve dhe komunitetit ta ngrisin zërin për çështjet që na prekin ne si shoqëri, dhe jo vetëm secilin si individ.

Metodologjia jonë ka nxitur edhe frymën e vullnetarizmit. Studentët e interesuar, të cilët nuk do të mund të marrin pagesë për angazhimin e tyre, janë nxitur **të dorëzojnë ankesa në Këshill** e kjo është theksuar **në kuadër të trajnimeve të studentëve për Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës.**



# Raporti i shkeljeve etike

Qëllimi i këtij raporti është evidentimi i shkeljeve të etikës së gazetarisë nga mediat online të Kosovës të cilat janë monitoruar nga 1 maji 2018 deri më 30 prill 2019. Duke marrë parasysh se shpesh shohim raportime të shumta të cilat nuk i përmbahen etikës së gazetarisë të paraparë me Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës dhe se ndaj tyre shkrimeve rrallë ngritën ankesa nga palët e përfshira, qëllimi i monitorimit të disa mediave online ka qenë të identifikohen këto shkrime dhe për disa prej tyre të dërgohet ankesë pranë Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).

Janë monitoruar gjithsej 8 media online dhe shkrimet e publikuara prej tyre janë monitoruar në baza ditore.

Në bazë të të dhënave që janë nxjerrë nga monitorimi i shkrimeve për periudhën maj 2018 deri në prill të vitit 2019, rezulton se në KMSHK janë dërguar 92 shkrime, përkatësisht ankesa. Këto shkrime janë dërguar duke ngritur dyshime se mediat të cilët i kanë publikuar ato, kanë bërë shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Nga totali prej 92 ankesave të cilat i janë dërguar KMSHK-së, kjo e fundit ka miratuar 41 prej tyre.

Duhet theksuar se prej kur ka filluar dërgimi i shkrimeve për shkak të dyshimit se kanë shkelur kodin e etikës, pas disa muajve tek mediat që kanë qenë nën monitorim është vërejtur kujdes i shtuar gjatë raportimit. Kjo për faktin se kur dërgohet një ankesë në KMSHK, ky këshill kërkon edhe nga mediumit ndaj të cilit është bërë ankesë përgjigje për shkrimin përkatës.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se në këtë periudhë kohore kur është bërë monitorimi i mediave përkatëse, më së shumti janë evidentuar shkelje të Kapitullit II, i cili ka tetë pika që kanë të bëjnë me “Raportimin e së vërtetës”.

Në vazhdim të raportit mund të gjenden të dhëna të ndryshme nga monitorimi i disa mediave si dhe filtrime të ndryshme të të dhënave sa i përket mediave që kanë bërë shkelje të etikës së gazetarisë, konkretisht kapitujve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës që janë shkelur.

# Shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara

Sipas kryetarit të bordit të KMSHK-së Imer Mushkolaj, mediat online kanë probleme me respektimin e Kodit edhe vazhdimisht ka shkelje të Kodit, shkelje që kanë të bëjnë me Kapitullin II – respektimin e së vërtetës edhe që në vete ngërthen edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me raportimin e së vërtetës. “Po ashtu, ka edhe shkelje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtën për t’u përgjigjur, ku disa media të caktuara kur e realizojnë një storie nuk i japin mundësi folësit për ta dhënë mendimin e tij ose të saj”, thotë Mushkolaj.

Arsye tjetër e shkeljeve të Kodit të Etikës sipas Mushkolaj është edhe aspekti profesional dhe mospërgatitja e duhur e atyre që punojnë, sidomos në mediat online. Ata vet i përgatisin lajmet dhe vet i publikojnë ato.

“Unë besoj që nuk luan shumë rol në kuptimin e nxitjes së lexuesve nëse e publikon fytyrën e plotë të një fëmije ose nëse e publikon me fytyrë të mbuluar. Pra, unë besoj që bëhen më shumë për shkak të moskujdesit”, thotë Mushkolaj. Ai thotë se për shkak se raste të tilla po dërgohen në KMSHK, ka një përmirësim të raportimeve në këtë aspekt.

Duke qenë pjesë e jetës publike dhe mediale, Mushkolaj thotë se has në shkrime të shumta të cilat nuk e respektojnë kodin e etikës. Ai thotë se e kupton dinamikën e lajmeve online dhe rëndësinë e raportimit sa më të shpejtë, por edhe në këto raste duhet të respektohet domosdo Kodi i Etikës. Të paktën në raste të raportimeve të tilla, ai thotë se lajmi i shpejtë duhet të përcillet dhe të plotësohet

në vazhdimësi të raportimit, në mënyrë që shkrimi të jetë në përputhje me Kodin.

Në rastet kur ka shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, përveç palëve të përfshira dhe që konsiderojnë që është shpifur apo janë fyer përmes shkrimeve, Mushkolaj thotë se ka edhe qytetarë të rëndomtë që dërgojnë nganjëherë ankesa në KMSHK edhe pse ata nuk janë të përfshirë në ato shkrime, por nuk u ka pëlqyer diçka në shkrimet që i kanë lexuar. Këtë e konsideron si diçka pozitive që duhet stimuluar edhe më shumë.

“Është një lloj vetëdijësimi në përgjithësi sidomos në këtë ‘boomin’ e mediave online, qytetarët janë të hutuar dhe ende nuk e dinë se cila është ajo përmbajtja që ia vlen të konsumohet dhe cila është ajo tjetra që nuk ia vlen. Unë besoj që me kalimin e kohës do të ndodhë filtrimi i këtyre mediave dhe atyre që unë i quaj të ashtuquajtura, për shkak se megjithatë të jesh media dhe të jesh pjesë e këshillit duhet ta dish se kush je ti, duhet të kesh adresën, impresumin dhe të gjitha ato elemente që e bëjnë një media të jetë media”, theksoi Mushkolaj.

Ai tregon se ka shumë media online për të cilat nuk dinë se kush janë, sepse nuk kanë as adresë dhe as kush qëndron prapa tyre dhe është shumë problem edhe për t’i gjetur dhe të kërkohet prej tyre që të bëhen pjesë të këshillit të mediave. Të tillat zakonisht bëjnë zakonisht më së shumti shkelje të kodit të etikës përmes shkrimeve tendencioze dhe shpesh të pavërteta.

# Shkeljet e evidentuara gjatë periudhës njëvjeçare

Nga monitorimi i realizuar ndaj tetë medimeve online, nga maji i vitit 2018 deri në prill të vitit 2019 janë evidentuar gjithsej 92 shkrime tek të cilat monitoruesit kanë vërejtur se ka dyshime për shkelje të kapitujve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.



**DIAGRAMI 1:** Ankesat e dërguara në KMSHK, maj 2018 - prill 2019


	Numri i Ankesave të dërguara	Të miratuara	Të pa miratuara
	SEND	✓	X
Gazeta Express	2	1	1
Gazeta Zëri	12	8	4
Indeskonline	19	8	11
Insajderi	5	3	2
Telegrafi	8	0	8
Gazeta Blic	18	9	9
Kossev	13	4	9
Veriu.info	15	8	7

Pasi që një ankesë dërgohet në KMSHK, ky institucion vetërregullues merr vendime lidhur me pranimin ose jo të ankesës. Pas shqyrtimit të shkrimit, bordi i KMSHK-së merr vendim ta miratojë ankesën, ta miratojë pjesërisht, ose të mos e miratojë, duke konkluduar se shkrimi përkatës i ka plotësuar kriteret e përcaktuara nga Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës. Por ka edhe raste kur disa raste zgjidhen me ndërmjetësim.

Kryetari i bordit të KMSHK-së Imer Mushkolaj, tregon nga përvoja e tij se shumica e ankesave që i adresohen këtij institucioni miratohen.

Disa nga rastet ku pretendohet se është bërë shpifje ose fyerje fillimisht shkojnë në KMSHK dhe vendimi i këtij trupi vetërregullues merret për bazë në ndonjë proces gjyqësor që mbahet, në rastet kur dikush bën padi civile ndaj dikujt. Por Mushkolaj thotë se ka edhe raste kur rasti fillimisht shkon në gjykatë pastaj të kërkohet mendimi profesional nga KMSHK për një rast të caktuar. Ai thekson se prokuroritë dhe gjykatat kanë mungesë të njerëzve të cilët do të ishin më të informuar se si t'ju qasen rasteve që kanë të bëjnë me media.


“Ankesat që vijnë në Këshill janë të bëra gati për gjykatë, por palës i intereson shumë se çka po mendohet në aspektin profesional bazuar në Kod dhe pastaj gjykata vendos bazuar në ligj. Kështu që këto dy gjëra nuk duhet të përzihen dhe natyrisht interpretimi në bazë të Kodit është me i gjerë, për shkak se ne e dimë si njerëz të mediave se megjithatë ndonjëherë ti i interpreton pak më gjerë një qasje që e ka dhënë një medium për një titull, për një etiketim, e kështu me radhë. Ndërkohë që gjykata është më strikte, por ne zakonisht u bëjmë thirrje palëve që rastin ta dërgojnë në gjykatë”, thotë Mushkolaj.



“Ankesat që vijnë në Këshill janë të bëra gati për gjykatë, por palës i intereson shumë se çka po mendohet në aspektin profesional bazuar në Kod dhe pastaj gjykata vendos bazuar në ligj. Kështu që këto dy gjëra nuk duhet të përzihen dhe natyrisht interpretimi në bazë të Kodit është me i gjerë, për shkak se ne e dimë si njerëz të mediave se megjithatë ndonjëherë ti i interpreton pak më gjerë një qasje që e ka dhënë një medium për një titull, për një etiketim, e kështu me radhë. Ndërkohë që gjykata është më strikte, por ne zakonisht u bëjmë thirrje palëve që rastin ta dërgojnë në gjykatë”, **thotë Mushkolaj.**

Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës i ka dhjetë kapituj. Secili kapitull i ka disa pika ku flitet në mënyrë të detajuar për etikën që gazetarët, përkatësisht mediumet duhet t'i përmbahen. Gjatë monitorimit tonë dhe krijimit të databazës, shkeljet e evidentuara janë ndarë edhe sipas kapitujve, në mënyrë që të shihet se cilët kapituj, përkatësisht pika të kapitujve, po shkelën më së shumti nga mediumet që kanë qenë duke u monitoruar.

**DIAGRAMI 2: Shkeljet e evidentuara dhe të dërguara në KMSHK sipas Kapitujve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës**




Rezultatet e monitorimit tregojnë se më së shumti shkrime, gjithsej 47, që janë evidentuar dhe pastaj janë dërguar në KMSHK, kanë të bëjnë me Kapitullin II të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. KMSHK-ja ka miratuar 20 prej tyre.

Ky kapitull përbëhet nga shtatë pika dhe ka të bëjë me trajtimin e së vërtetës. Në këtë pikë thuhet se duhet të bëhet dallim i qartë ndërmjet lajmeve dhe opinioneve. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, kurse opinionet bartin mendime, ide, besime apo gjykime vlerësuese nga ana e botuesve, gazetarëve dhe redaktorëve.

Imer Mushkolaj thotë se një nga shkaqet që ka shkelje të shpeshta të kodit të etikës, sidomos tek raportimi i së vërtetës, është fakti se shumica e mediave e kanë zgjedhur shpejtësinë para saktësisë dhe se kjo është një problem shumë i madh.























Ai thotë se shumica e mediave online janë më të prira për të publikuar diçka që nuk i plotëson të gjitha kriteret e të qenit një lajm ose një raportim profesionist, korrekt, por i publikojnë si të tilla.

“Natyrisht, jo të gjitha mediat, por po flasim për mediat që mund të kenë shkrime tendecioze që dihet dhe vërehet që janë tendecioze, por poashtu edhe në raste të caktuara kur përmes shkrimeve e përmbajtjeve mediale vihet në shënjestër një person, një organizatë, biznes e kështu me rradhë”, thotë Mushkolaj, duke shtuar se shpeshherë ndodh që mediat të publikojnë shkrime të qëllimshme në të cilat vihet në shënjestër personi, organizata ose biznesi me idenë që pastaj të përfitojnë nga kjo mënyrë e raportimit.



Ky kapitull përbëhet nga shtatë pika dhe ka të bëjë me trajtimin e së vërtetës. Në këtë pikë thuhet se duhet të bëhet dallim i qartë ndërmjet lajmeve dhe opinioneve. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, kurse opinionet bartin mendime, ide, besime apo gjykime vlerësuese nga ana e botuesve, gazetarëve dhe redaktorëve.


**DIAGRAMI 3:** Shkeljet e evidentuara dhe të dërguara në KMSHK nga Kapitulli i II i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës

KAPITULLI 2	Numri i ankesave të dërguara	Të miratuara	Të pa miratuara
	SEND	✓	X
Veriu.info	8 	7 	1 
Kossev	6 	0	6 
Gazeta Blic	9 	4 	5 
Telegrafi	5 	0	5 
Insajderi	4 	3 	1 
Indeskonline	5 	2 	3 
Gazeta Zëri	8 	2 	6 
Gazeta Express	2 	1 	1 





















Një nga kapitujt që është shkelur nga mediat që i kemi monitoruar është kapitulli VII i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Nga 92 shkrimet e dërguara 17, kanë të bëjnë me këtë kapitull. Ndërkaq KMSHK ka miratuar gjashtë prej tyre.

Ky kapitull ka të bëjë me privatësinë. “Gazetat, portalet dhe agjencitë e lajmeve do t’u shmangen ndërhyrjeve dhe kërkimeve në jetën private të një individi, përderisa ndërhyrje apo kërkime të tilla janë të nevojshme për arsye të interesit publik”, thuhet në pikën 1 të këtij kapitulli.



**DIAGRAMI 4:** Shkeljet e evidentuara dhe të dërguara në KMSHK nga Kapitulli VII i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës

KAPITULLI 7	Numri i ankesave të dërguara	Të miratuara	Të pa miratuara
	SEND	✓	X
Gazeta Express	2 	1 	1 
Gazeta Zëri	2 	1 	1 
Indeskonline	4 	2 	2 
Insajderi	0	0	0
Telegrafi	2 	0	2 
Gazeta Blic	2 	0	2 
Kossev	1 	0	1 
Veriu.info	4 	2 	2 

Gjatë monitorimit janë vërejtur edhe shkelje të shumta në Kapitullin X të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Nga totali prej 92 shkeljeve të supozuara që janë dërguar në KMSHK, shtatë kanë qenë nga ky kapitull. Sipas të dhënave që kemi marrë nga KMSHK-ja, shtatë prej tyre janë miratuar.

Në këtë kapitull thuhet se reklamimi komercial e politik, si dhe materiali sponsorizues - përfshirë këtu edhe artikuj e shtojca - duhet të dallohet qartë nga përmbajtja editoriale dhe të identifikohet si i tillë si dhe materiali i sponsorizuar do të tregojë qartë burimin e sponsorizimit.

Lidhur me këto shkelje, Imer Mushkolaj thotë se evidentohen shumë shkelje ngase mediat, sidomos ato online, e publikojnë një shkrim për ndonjë koleg apo spital privat dhe nuk e cekin se është reklamim. Kjo për faktin se aty ka cilësime mbi nivelin profesional të atyre për të cilët shkruhet. Mushkolaj thotë se pas shqyrtimit të disa rasteve të tilla, pat pasur një përmirësim në raportime të tilla.

Gjithashtu është evidentuar se edhe Kapitulli i III Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës është shkelur gjatë raportimeve që i kanë bërë mediat online të cilat kanë qenë nën monitorim në periudhën maj 2018 - prill 2019. Sipas të dhënave të monitorimit, nga 92 shkrimet e dërguara në KMSHK, lidhur me Kapitullin III janë dërguar 13 shkrime. Gjashtë prej tyre janë miratuar.

Kapitulli III i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, rregullon përkatësisht sanksionon rastet e artikujve lidhur me nxitjen dhe gjuhën e urrejtës.

Në pikën 1 të këtij Kapitulli thuhet se shtypi, portalët dhe agjencitë e lajmeve nuk do të nxisin veprimet kriminale apo të dhunshme, pavarësisht nga situata apo rrethana.

“Ankesat që vijnë në Këshill janë të bëra gati për gjykatë, por palës i intereson shumë se çka po mendohet në aspektin profesional bazuar në Kod dhe pastaj gjykata vendos bazuar në ligj. Kështu që këto dy gjëra nuk duhet të përzihen dhe natyrisht interpretimi në bazë të Kodit është me i gjerë, për shkak se ne e dimë si njerëz të mediave se megjithatë ndonjëherë ti i interpreton pak më gjerë një qasje që e ka dhënë një medium për një titull, për një etiketim, e kështu me radhë. Ndërkohë që gjykata është më strikte, por ne zakonisht u bëjmë thirrje palëve që rastin ta dërgojnë në gjykatë”, **thotë Mushkolaj.**

Në pikën 2 thuhet se shtypi, portalet dhe agjencitë e lajmeve do të bëjnë të gjitha që mundën për të mos nxitur apo ushqyer urrejtje dhe pabarazi përmes: a. *Trajtimin me paragjykim të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore;* b. *Përdorimit të shprehjeve denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore.*

Ndërsa pika 3 thotë se referencat rreth përkatësisë etnike të një individi, referencat racore, fetare, gjinore, të orientimit seksual apo rreth paaftësisë fizike e mendore do të zhvillohen vetëm në rastet kur informacionet e tilla kanë rëndësi të drejtëpërdrejtë për ngjarjen për të cilën raportohet.

**DIAGRAMI 5:** Shkeljet e evidentuara dhe të dërguara në KMSHK nga Kapitulli III i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës

KAPITULLI 3	Numri i ankesave të dërguara	Të miratuara	Të pa miratuara
	SEND	✓	X
Gazeta Express	0	0	0
Gazeta Zëri	0	0	0
Indeskonline	3 	1 	2 
Insajderi	0	0	0
Telegrafi	0	0	0
Gazeta Blic	0	0	0
Kossev	7 	4 	3 
Veriu.info	3 	1 	2 

# Rritja e numrit të ankesave dhe ndikimi i shqyrtimit të tyre

Viteve të fundit ka një trend të rritjes së ankesave që i drejtohen KMSHK-së. Këtë e konfirmon edhe kryetari i bordit të këtij institucioni Imer Mushkolaj. Ai thotë se ankesat vijnë nga palë të ndryshme, duke përfshirë institucionet më të larta të shtetit, politikanë, biznese, e deri tek qytetari i thjeshtë. Ankesat e të gjithëve sipas tij trajtohen njësoj.

Rritja e numrit të ankesa ka pasur ndikim që disa media t'i kuptojnë gabimet në raportime dhe të përmirësohen me kalimin e kohës.

Procedura është e tillë, paraprakisht ankesat u dërgohet anëtarëve të kuvendit apo të bordit për ta kuptuar më lehtë dhe gjithashtu mediave për të cilat palët janë ankuar, priten përgjigjet dhjetë ditore deri sa të kthehet prej mediave të caktuara nëse kanë diçka për të shtuar.

“Nuk janë të gjitha, por ato media që janë anëtare të këshillit vinë dhe marrin pjesë në mbledhje dhe

më e mira e kësaj pune është që mbledhen tridhjetë vetë dhe diskutojnë për shkeljet që ka bërë dikush që është pjesë e këshillit.

Prandaj nuk është turpërim por një farë aspekti morali e bën të vetën. Nuk vihet në shënjestër dikush, por unë nuk isha ndjerë mirë nëse tridhjetë vetë kishin biseduar për një shkelje të pretenduar që e ka bërë dikush nga anëtarët”, thotë Mushkolaj.

Në këtë aspekt vendimet e Këshillit të Mediave, si një trup ekzekutiv kanë ndikim pozitiv në përmirësimin e raportimeve mediale tek mediat e shkruara dhe respektimin sa më të madh të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

KMSHK në këto raste nuk shqipton gjoba, por në mënyrë vullnetare i trajton ato raste, duke specifikuar shkeljet e gjetura.

# Përfundime

Rritja e numrit të mediave online ka rritur edhe numrin e shkeljeve të etikës në gazetari. Shpesh në media online shohim raportime tendencioze, raportime që nuk i kanë përfshirë të gjitha palët në një artikull, raste kur një shkrim më shumë përmban opinion dhe vlerësim, subjektiv sesa që bazohet në një raportim korrekt, duke prezantuar faktet dhe përfshirë të gjitha palët e përmendura në shkrim.

Monitorimi i bërë nga organizata ÇOHU për periudhën maj 2018 - prill 2019, tregon se ka shkelje të ndryshme të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Gjatë këtij monitorimi janë përzgjedhur 8 media online, të cilat janë monitoruar në baza ditore. Disa nga to janë ndër më të klikuarat, ndërsa disa janë portale që më shumë raportojnë për një komunë apo rajon të caktuar në Kosovë. Gjithashtu është monitoruar edhe një medium online në gjuhën serbe.

Prej se ka filluar dërgimi i ankesave ndaj disa mediave online për dyshime se kanë shkelur Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, me kalimin e muajve ka filluar të vërehet një kujdes më i shtuar në raportim nga ato medime. Kjo për faktin se kur dërgohet një ankesë në KMSHK, ky trup vetërregullues kërkon edhe nga mediumit ndaj të cilit është bërë ankesë, një përgjigje për shkrimin përkatës.

Se ka pasur ndikim, e tregojnë edhe të dhënat nga monitorimi. Në periudhën prej fundit të muajit maj, deri në dhjetor 2018, në KMSHK janë evidencuar dhe janë dërguar 120 shkrime, që i bie rreth 17 ankesa në muaj. Ndërsa në periudhën janar - prill 2019 ankesa janë dërguar vetëm për 40 shkrime, që i bie të jenë dërguar vetëm 10 ankesa në muaj.

Këto të dhëna nga monitorimi i disa mediave online, tregojnë se në përditshmëri ka shkelje të kodit të etikës dhe se vetëm një numër i vogël i tyre dërgohen në formë të ankesave në KMSHK. Prandaj është i domosdoshëm një vetëdijësim më i madh i mediave për të respektuar etikën e gazetarisë. Të dhënat tregojnë se mediat shpesh e ngatërrojnë me ose pa qëllim opinionin me shkrimin gazetaresk apo raportimin. Në këtë mënyrë ato bëjnë konstatime, vlerësime dhe përfundime subjektive, pa iu referuar ndonjë burimi, apo pa i marrë edhe qëndrimet e palëve të përmendura në shkrim.

Në anën tjetër ka nevojë edhe për një vetëdijësim më të madh të qytetarëve për t'i dërguar në KMSHK rastet kur pretendojnë se ndaj tyre është shpifur apo janë fyer në ndonjë shkrim të caktuar të publikuar nga mediat e shkruara. Gjithashtu, nevojitet ngritja e vetëdijësimit të tyre për të ditur të drejtën e tyre për të bërë ankesë tek një institucion vetërregullues siç është Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës.



